

VENDIM
Nr. 50/2026

**PËR MOSZGJEDHJEN E NJË KANDIDATURE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT
TË KONKURRENCËS TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Moszgjedhjen e kandidaturës së zotit Eldian Balla si anëtar të Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 2.4.2026.